



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:037581

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05755309

**C.nr.1089/2023**

**GJYKATA THEMLORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.L. nga Skenderaj, të cilën e përfaqëson Q.R. avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim për shujta, duke vendosur sipas marrëveshjes se palëve të arritur nga ndërmjetësuesit N.O. dhe F.O., ndërmjetësues të licencuar, bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe pas vlerësimit të marrëveshjes se palëve të arritur në ndërmjetësim, me dt.30.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- APROVOHET** Marrëveshja ND.829/2023 e dt.21.03.2024 e arritur në procedurën e ndërmjetësimit në lëndën C.nr.1089/2023.
- Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
- Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse edhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
- Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë në procedurë të veçantë gjyqësore.

Gjyqtari  
Hajrullah Aruqi